



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE**  
**VLORE**

Nr.Regj.Them 1938  
Dt.Regj 11.11.2015

Nr.1729. Vendimi  
Datë 16.12.2015

**V E N D I M**

**“Në emër të Republikës”**

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore, e përbërë prej :

**Gjyqtar- Astrit Shema**

asistuar prej sekretares gjyqesore Anila Rista, në Vlore, sot më datë 16.12.2015 përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqesore publike çështjen civile me Nr. 1938. Regj.Them, date paraqitje 11.11.2015, që i përket paleve ndergjyqese :

**PADITES:** Shoqeria Zyre Avokatie "Syri & B", sh.p.k me adrese lagja "Iliria", perballe gjykates se rrethit gjyqesor Berat, tel.0692986641, perfaqesuar ne gjykim me autorizim date 07.12.2015 leshuar prej admnistratorit Shuaip Syri nga aan e av.Armanado Syri, me nr.lic.5256.

**TE PADITUR:** 1.Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, Tirane, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim me nr.38658.Prot,date 26.11.2015 nga ana e jurists se DT Berat zj.Silvana Ballo.

2.Drejtoria Rajonale Tatimore, Berat, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim me nr.6240/3Prot,date 02.12.2015 nga ana e jurists se DT Berat zj.Silvana Ballo.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e Njoftim Vleresimit Per detyrimet, nr.2643 prot, date 11.06.2015, te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat dhe vendimit nr.21935/2 Prot, date 08.10.2015 se Drejtorise se Apelimit Tatimor, Tirane.

**BAZA LIGJORE:** nenet 17, 18 e 42 te Kushtetutes, neni 6 i KEDNJ, neni 1 i Protokollit nr.I i KEDNJ, K.Pr.Civile, Ligji nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", ligji K.Pr.Administrative, ligji nr 10279, date 20.05.2010 "Per Kundravajtjet Administrative", ligji nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise dhe Udhezimi nr.24, date 02.09.2008 I ndryshuar.

Gjykata pasi mori provat e nevojeshme, degjoi ne kerkimet perfundimtare palet ne proces te cilat u shprehen respektivisht :

**Paditësi**-nepermjet te autorizuarit te tij- **kërkoj**: Pranimin e padisë,

**Perfaqesuesia I paleve te paditura** : Rrezimin e padisë;

si e analizoi çeshtjen ne teresine e saj :

### VEREN:

Paditesi i është drejtuar kesaj gjykate, me padine e mesipercituar me object gjykimi.

Gjykata, pasi studioi materialet e çështjes civile me Nr.1938.Akti , date 11.11.2015.Rregj te paraqitur per gjykim, ne baze te nenit 36 te K.Pr.Civile, ne te cilin parashikohet shprehimisht se: "Ne juridiksionin e Gjykatave hyjne te gjitha mosmarreshjet civile dhe mosmarreshje te tjera te parashikuara ne kete Kod e ne ligje te vecanta" si dhe ne reference dhe te nenit 7 te ligjit me nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ne te cilin citohet se : " Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;duke qene se ndodhemi perpara nje mosmarreshje me karakter administrativ qe rrjedh nga marrëdhëniet civile mes paleve ndergjyqese", çmoi kryesisht se çështja e paraqitur eshte ne kompetencen lendore te kesaj gjykate.

Gjithashtu ne reference te nenit 10 te ligjit te mesipercituar "Kompetenca funksionale" ne te cilin citohet se : " 1. Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normative,arriti ne kunkludimin se kjo çështje eshte nen kompetencen funksionale te kesaj gjykate.

Ne lidhje me kompetence tokesore kjo gjykate j'u referuar nejit 11 te ligjit me nr. 49/20012"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" ne te cilin citohet se "1. Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet.-Në rastet kur organi administrativ më i lartë, pas ankimit administrativ, e ndryshon aktin administrativ të organit vartës, padija ngrihet në gjykatën që përfshin territorin ku ka qendrën organi administrativ më i lartë.

Gjithashtu Gjykata, në vështrim të neneve 12 te ligjit te mesipercituar, çmoi çështje duhet gjykuar me nje gjyqtar te vetem.

### Rrethanat e ceshtjes

Shoqëria ZYRË AVOKATIE"SYRI & B" me Nipt L328020010, është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat "Aktivitet Juridike", me adresë të aktivitetit në lagjen "Iliria (10 Korriku)" Berat. Shoqëria i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me objekt padije "Shfuqizimin e akteve administrative....." ne lidhje me njoftim vlersimin nr.2643 date 11.06.2015.

Me anë të Njoftim Vlersimit nr.2643 date 11.06.2015 dërguar nga DRT Berat, subjektit i është komunikuar penalteti në vlerë 50 000 lekë për punonjës të padeklaruar, bazuar në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqiperisë" i nryshuar, neni 119 pika 1 germa b.

Pala paditëse e ka ankimuar aktin administrative për detyrimet tatimore Njoftim Vlersimit nr nr. 2643 date 11.06.2015, në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin nr.21935/2 date 08.10.2015 (prot me DRT Berat me nr.2643/1 date 12.10.2015) ka vendosur: "Lënien në fuqi të aktit administrative Njoftim Vlersimin për detyrimet tatimore nr. 2643 date 11.06.2015 të nxjerrë nga DRT Berat".

Pala paditese,brenda afatit ligjor te paarshikar nga neni 18 i ligjit me nr.49/2012"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"l eshte drejtuar kesaj gjykate me padine object gjykimi duke kerkuar sipas saj.

### **Pretendimet e pales paditese**

Paditesi Zyra Avokatie Syri & B ushtron Aktivitet Juridik dhe objekt: Dhenie e ndihmes juridike, keshillime ligjore per ceshtje ne ndryshme, pergatitje te kerkese padive dhe kerkeseve te tjera gjateprocedimitpenal, administrativ etj. Drejtoria Rajonale Tatimore Berat njofton ankuesit se ka te pa pagaura detyrimet e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore deri me date 11.06.2015. Me Njoftim Vleresimin Per Detyrimet Tatimore nr.2643 prot, date 11.06.2015, te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Berat shoqeria Zyre Avokatie Syri & B sh.p.k, detyrohet te paguaje gjobe ne shumen 50.000 (pesedhete mije) leke. Paditesi ka paraqitur ankim ne Drejtorine e Apelimit Tatimor dhe me vendimin nr.21935/2 Prot, date 08.10.2015 ka vendosur:

-Lenien ne fuqi te gjobes ne shumen 50.000 leke, percaktuar ne aktin administrativ, Njoftim Vleresimin per Detyrimet Tatimore nr.2643, date 11.06.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, per mosdeklarim te nje punonjesi ne organin tatimor. Paditesi i ka paguar detyrimet e kontributeve e cila vertetohet me mandatin e pageses date 16.03.2015 ne shumen 20.646 (njetzmije e gjashteqind e dyzet e gjashte) leke si detyrim mujor.

Aktet e mesiperme vijne ne kundersiztim me ligjin dhe cenojne interesat ekonomike te paditesit.

Punonjesi Jonel Syri ka filluar pune prane paditesit qe ne fillim te muajit qershor te vitit 2015 dhe per shkak te mbingarkeses ne sistemin elektronik te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve nuk eshte bere e mundur deklarimi i ketij punonjesi. Ne nenin 111, pika 4 te ligjit nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise" percaktohet:

-Gjobat e vendosura per shkelje tatimore administrative mund te hiqen ne rrethana te jashtezakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor eshte shkaktuar nga fatkeqesi natyrore apo **rrethana te tjera te jashtezakonshme....** Ne kete rast paditesi nuk kishte mundesi te bente deklarimin e punonjesit qe ne fillim te muajit per shkak te bllokimit elektronik te faqes zyrtare te tatimeve. Sic shihet qarte edhe urdher pagesat per detyrimet e muajit maj jane nxjerre me date 12.06.2015 dhe me veshtiresi pas shume e shume klikimeve online.

Gjithashtu punonjesi i pa deklaruar nuk mund te quhet i tille pasi nga ekstrakti i nxjerre nga Q.K.R. punonjesi eshte ortak me palen paditese.

Aktet e mesiperme vijne ne kundersiztim me ligjin dhe cenojne interesat ekonomike te paditesit. Perfundimisht kerkojme nga gjykata qe ne baze te nenet 17, 18 e 42 te Kushtetutes, neni 6 i KEDNJ, neni 1 i Protokollit nr.I i KEDNJ, K.Pr.Civile, Ligji nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", ligji K.Pr. Administrative, ligji nr 10279, date 20.05.2010 "Per Kundravajtjet Administrative", ligji nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise dhe Udhezimi nr.24, date 02.09.2008 l ndryshuar te vendose:

Pranimin e padise, sipas objektit të saj.

### **Prapësimet e pales se paditur**

Nga verifikimet e kryera në organin tatimor, është konstatuar se nga ana e subjektit është bërë rregjistrimi elektronik i të punësuarit Jonel Syri, por pas kryerjes së kontrollit.

Kjo e konfirmuar nga deklarimi i fuqisë puntore e bërë nga vet subjekti, deklarim i cili është bërë në datë 12.02.2015, pra një ditë pasë kryerjes së kontrollit, por duke e regjistruar Jonel Syrin si datë të fillimit të punës më datë 10.02.2015 (deklarim i cili nuk e shmangë paditësin nga penalteti për mosdeklarim të fuqisë puntore)

Pretendimi i paditësit në kërkesë padinë e tij se nuk kishte mundësi të bënte deklarimin e punonjesit për shkak të bllokimit të faqes elektornike të tatimeve nuk qendron, pasi subjekti nuk ka sjell asnjë provë në favor të pretendimit të tij.

Në rastë se shoqëria do të kishte hasur vështirësi në deklarimin e fuqisë puntore në faqen elektronike të tatimeve, atëherë ajo duhet me anë të një shkrese ta vinte në dijeni Drejtorinë Rajonale në lidhje me problematiken e hasur, për pamundësin e deklarimit të fuqisë puntore, si dhe referuar Kreun III "Format dhe procedurat e dorzimit të deklaratave" germa "a", pika 1, e Udhezimit të Ministrit të Financave nr.26, date 16.04.2009, është percaktuar se: "Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi dhe të larguarve nga puna formulari E-SIG 027/a, nga të gjitha subjektet duhet të dorzohet në dy kopje në protokollin e Drejtorisë Rajonale Tatimore".

*"Punonjes i protokollit pasi vendos në formular datën e marrjes në dorzim, e nënshkruan dhe vulos, një kopje ja jep subjektit përkatës, ndërsa kopja tjetër administrohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore".*

Pranë organit tatimor nuk është sjell ndonjë formular E-SIG 027/a për ndryshimin e fuqisë puntore, po ashtu si dhe nuk është bërë as deklarim në faqen elektronike të tatimeve.

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në bazë të verifikimeve të kryera, ka ndjekur procedurat e mëtejshme ligjore dhe në ka nxjerrë aktin administrative, Njoftim-Vlersimi objekt ankimi, me nr.2643 date 11.06.2015, me anë të së cilit i është vendosur penalteti subjektit për mosdeklarim të të punësuarit në vlerën 50 000 leke, bazuar në ligjin Nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i nryshuar, nën 119 pika 1 germa b, si dhe në Udhezimin nr.24 date 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" në nenin 119/1, pika b.

Në zbatim të ligjit nr.9920, date 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) nën 68 "Vlersimi Tatimor" dhe Udhezimit të Ministrit të Financave nr.24 date 20.09.2008, pika 68.3.1 është percaktuar se:

*"Administrata tatimore ka autoritetin dhe detyrimin për të mbikqyrur gjithë procesin e detyrimeve tatimore të personave të tatueshem".*

Në bazë të dispozitës së sipërcituar administrates tatimore i lind e drejta e kryerjes së vlersimit të detyrimit tatimor i cili bazohet në informacionet që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit, rezultatet e kontrollit apo menytrat alternative të vlersimit.

Në zbatim të ligjit nr.9136, date 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shendetesore në RSH-se" dhe referuar në Kreun III "Format dhe procedurat e dorzimit të deklaratave" germa "a", pika 2, e Udhezimit të Ministrit të Financave nr.26, date 16.04.2009, është percaktuar se:

*"Pasqyrën e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna" E-SIG 027/a mund ta dërgojnë në drejtorinë rajonale tatimore me postë rekomande. Në këtë rast, dorëzimi konsiderohet brenda afatit kur data e postimit është të paktën 48 orë përpara fillimit të punës për çdo të punësuar rishtazi dhe për të larguarit nga puna brenda 10 ditëve...".*

ndryshuar.

- Ligji nr.9136, date 11.09.2003 "Per Mbledhjen e Kontributeve te Detyrueshme te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore ne RSH-se"

- Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.26, date 16.04.2009

### **Zgjidhja ligjore**

**Gjykata** ne lidhje me barren e proves , ka per reference nenin 35 te ligjit me nr. 49/2012" Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"-Barra e .proves ne te cilin citohet se :*"1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.*

Duke vlerësuar në tërësi rrethanat faktike të provuara në gjykim nëpërmjet provave shkresore, thëniet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse, të çmuara në përputhje me nenet 10,11,12, 29, 213, 214, 246 e vijues dhe 253 e vijues të KPrC dhe mbështetjen ligjore të padisë, si dhe duke referuar në hapësirën ligjore që krijon neni 16 i KPrC sipas të cilit *"Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen pa u lidhur me përcaktimet që mund të propozojnë palët."*, arrin në konkluzionin se padia duhet rrezuar për arsyet si më poshtë vijon:

Shoqëria ZYRË AVOKATIE"SYRI & B" me Nipt L328020010, është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat "Aktivitet Juridike", me adresë të aktivitetit në lagjen "Iliria (10 Korriku)" Berat. Shoqëria i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me objekt padije "Shfuqizimin e akteve administrative....." ne lidhje me njoftim vlersimin nr.2643 date 11.06.2015.

Me anë të Njoftim Vlersimit nr.2643 date 11.06.2015 dërguar nga DRT Berat, subjektit i është komunikuar penaliteti në vlerë 50 000 lekë për punonjës të padeklaruar, bazuar në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i nryshuar, neni 119 pika 1 germa b.

Pala paditëse e ka ankimuar aktin administrative për detyrimet tatimore Njoftim Vlersimit nr nr. 2643 date 11.06.2015, në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin nr.21935/2 date 08.10.2015 ( prot me DRT Berat me nr.2643/1 date 12.10.2015) ka vendosur: "Lënien në fuqi të aktit administrative Njoftim Vlersimin për detyrimet tatimore nr. 2643 date 11.06.2015 të nxjerrë nga DRT Berat"

Vlersimi tatimor është rrjedhojë e penalizimit nga inspektori i Drejtorisë së Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në DRT Berat, në bazë të informacionit të dërguar nga Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Jugor, me anë të shkresës nr.178 prot.datë 18.02.2015 (protokolluar në DRT Berat me nr.912 prot.date 20.02.2015 ) me lend: Dergim Akt-Konstatime

Shoqëria ZYRË AVOKATIE"SYRI & B", me Nipt L328020010 është penalizuar me gjobë në vlerën 50 000 lekë per mosdeklarim të fuqis puntore.

Inspektorët e Hetimit Tatimor të Rajonit Jugor, në bazë të detyrave të tyre funksionale, kanë mbajtur Akt-Konstatimin nr.serial 0455606

Në Aktin-konstatimi nr.serial 0455606 date 11.02.2015, nga inspektorët e kontrollit, është cituar

ndër të tjerë se:

*Në momentin e kontrollit në punë u gjendën: 1-Armando Syri dt.31.08.1983 dhe Jonel Syri dt.27.08.1989.*

*Mbahet ky akt konstatim për të bërë verifikimin përkatës nëse personat e mësipërm janë të siguruar në skemën e sigurimeve shoqërore, si dhe për veprimet e mëtejshme tatimore. Ky kontrolli u krye në orën 13.00"*

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, bazuar në Akt-konstatimin e mbajtur nga inspektorët e kontrollit, vendosur penalitetin (gjobë) në vlerën prej 50 000, për mosdeklarim të punonjesit Jonel Syri, në organin tatimor, bazuar në nenin 119, pika a, të ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar.

Nga verifikimet e kryera në organin tatimor, është konstatuar se nga ana e subjektit është bërë rregjistrimi elektronik i të punësuarit Jonel Syri, por pas kryerjes së kontrollit.

Kjo e konfirmuar nga deklarimi i fuqisë puntore e bërë nga vet subjekti, deklarim i cili është bërë në datë 12.02.2015, pra një ditë pasë kryerjes së kontrollit, por duke e regjistruar Jonel Syrin si datë të fillimit të punës më datë 10.02.2015 (deklarim i cili nuk e shmangë paditësin nga penaliteti për mosdeklarim të fuqisë puntore)

Pretendimi i paditësit në kërkesë padinë e tij se nuk kishte mundësi të bënte deklarimin e punonjesit për shkak të bllokimit të faqes elektronike të tatimeve nuk qendron, pasi subjekti nuk ka sjell asnjë provë në favor të pretendimit të tij.

Në rast se shoqëria do të kishte hasur vështirësi në deklarimin e fuqisë puntore në faqen elektronike të tatimeve, atëherë ajo duhet me anë të një shkrese ta vinte në dijeni Drejtorinë Rajonale në lidhje me problematiken e hasur, për pamundësin e deklarimit të fuqisë puntore, si dhe referuar Kreun III "Format dhe procedurat e dorzimit të deklaratave" germa "a", pika 1, e Udhezimit të Ministrit të Financave nr.26, datë 16.04.2009, është percaktuar se:

"Pasqyra e të punësuarve për herë të parë, atyre rishftazi dhe të larguarve nga puna formulari E-SIG 027/a, nga të gjitha subjektet duhet të dorzohet në dy kopje në protokollin e Drejtorisë Rajonale Tatimore".

*"Punonjes i protokollit pasi vendos në formular datën e marrjes në dorzim, e nënshkruan dhe vulos, një kopje ja jep subjektit përkatës, ndërsa kopja tjetër administrohet në Drejtorinë Rajonale Tatimore".*

Prane organit tatimor nuk është paraqitur ndonjë formular E-SIG 027/a për ndryshimin e fuqisë puntore, po ashtu si dhe nuk është bërë as deklarim në faqen elektronike të tatimeve.

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në bazë të verifikimeve të kryera, ka ndjekur procedurat e mëtejshme ligjore dhe në ka nxjerrë aktin administrative, Njoftim-Vlersimi objekt ankimi, me nr.2643 datë 11.06.2015, me anë të së cilit i është vendosur penaliteti subjektit për mosdeklarim të të punësuarit në vlerën 50 000 leke, bazuar në ligjin Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, **neni 119 pika 1 germa b**, si dhe në Udhezimin nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" në nenin 119/1, pika b, ku shprehet se:

*"Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta. Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë të subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklarim duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve. Në mbështetje të nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë*

19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", punonjësit e administratës tatimore, të autorizuar me shkrim, kryejnë verifikime e kontrole në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklarimin e numrit të punonjësve.

Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar, që fillon punë për herë të parë të tatimpaguesi apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së të vetëpunësuarit me të cilët ai punon e bashkëjeton), përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të papaguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimpaguesi përkatës detyrohet të paguajë edhe një gjobë prej:

a) 500 000 (pesëqind mijë) lekë kur është tatimpagues i regjistruar njëkohësisht për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe tatimin mbi fitimin; dhe

b) 50 000 (pesëdhjetë mijë lekë) për çdo rast mosdeklarimi për të gjithë tatimpaguesit e tjerë që nuk përfshihen në shkronjën "a" të kësaj pike.

Çdo konstatim i përsëritur i mosdeklarimit të punonjësve, pas aplikimit të dënimit administrativ, siç përcaktohet në pikën 119.1, konsiderohet evazion tatimor, sipas nenit 116 të ligjit, dhe administrata tatimore ushtron të drejtën e parashikuar në nenin 131, të ligjit, duke bërë kallëzimi penal për tatimpaguesin.

Në zbatim të ligjit nr.9920, date 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar) neni 68 "Vlersimi Tatimor" dhe Udhezimit të Ministrit të Financave nr.24 date 20.09.2008, pika 68.3.1 është përcaktuar se:

"Administrata tatimore ka autoritetin dhe detyrimin për të mbikqyrur gjithë procesin e detyrimeve tatimore të personave të tatueshem".

Në bazë të dispozitës së sipërcituar administratës tatimore i lind e drejta e kryerjes së vlersimit të detyrimit tatimor i cili bazohet në informacionet që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit, rezultatet e kontrollit apo menyrat alternative të vlersimit.

Në zbatim të ligjit nr.9136, date 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të Detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në RSH-se" dhe referuar në Kreun III "Format dhe procedurat e dorzimit të deklaratave " germa "a", pika 2, e Udhezimit të Ministrit të Financave nr.26, date 16.04.2009, është përcaktuar se:

"Pasqyrën e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna" E-SIG 027/a mund ta dërgojnë në drejtorinë rajonale tatimore me postë rekomande. Në këtë rast, dorëzimi konsiderohet brenda afatit kur data e postimit është të paktën 48 orë përpara fillimit të punës për çdo të punësuar rishtazi dhe për të larguarit nga puna brenda 10 ditëve...".

Nga verifikime në sistemin C@TS rezulton që ky punonjës është e padeklaruar me anë të formularit E-SIG 027/a, brenda afateve ligjore të sipërcituara.

Në pikën 80.03 c) të Udhezimit nr.24, date 02.09.2008, në zbatim të ligjit është përcaktuar se:

"Verifikimet në vend,

Këto verifikime të shkurtra synojnë zbulimin në kohë të shkeljeve që kanë lidhje me regjistrimin e personave të tatueshem (identifikimin e personave të peregjistruar), me përdorimin e pajisjeve fiskale, me përdorimin e pullave fiskale në mallrat e akcizës, me dokumentimin e mallrave në ruajtje, përdorim dhe transport, me dokumentimin e shitjeve dhe lëshimin e faturave tatimore, etj.

Këto verifikime kryhen pa njoftimin paraprak të personave të tatueshem, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit, të dokumentit personal të verifikuesit dhe urdhrin e ditës, të

*lëshuar nga drejtuesi i drejtorisë së kontrollit për verifikime në vend"*

Për sa me sipër, aktet administrative Njoftim Vlersimi për Detyrimet Tat 11.06.2015 i DRT Berat, dhe Vendimi Nr.21935/2 datë 08.10.2015, të Drejtorisë Tiranë, janë të mbështetur në ligj, si dhe mbështetur në Legjislacionet e sipërpërme

datë  
shmor

Sa me sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e paditësit është e pa m ne prova dhe, si rrjedhojë ajo duhet rrezuar.

dhe

Meqenëse kjo padi u rrezua nga ana e Gjykatës atëherë, ne mbësht K.Pr.Civile taksa mbi aktet, shpenzimet e tjera gjyqësore dhe për një avokat i ngarko

06 te  
se.

Vlen të theksohet se ku vendim ne mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.49/20 dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve e qene se kundërshtimi i aktit të pales se paditur përmban detyrimin ne të holla me njezetfishi i pages minimale, ne shkallë vendi, kundërshtim ketij vendimi nuk lejohe paankimueshem referuar dispozites ligjore të mesipercituar.

zimin  
duke  
gel se  
nte i

### **PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenin 126 dhe 310 të K.Pr.Civile dhe nenet nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrat mosmarreveshjeve administrative":

it me  
nin e

### **VENDOSI :**

Rrezimin e padisë.

Shpenzimet gjyqësore të ngarkohen palës paditese.

Ky vendim, ne mbështetje të nenit 45 të ligjit nr.49/2012 « Për organizim gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative » është shkallët me të larta të gjyqësorit.

imin e  
em ne

U shpall në Vlore, sot më dt. 16.12.2015

**SEKRETARE**

Anila Rista



**GJYKATA**

Astrit Sher



**SHPENZIMET GJYQËSORE**

Takse padie 3.000 leke

Takse njoftimi 200 leke

Shuma totale 3.200 leke

